LIGJ
Nr.8307, datë 14.3.1998

PËR ZHVILLIMIN E ROTACIONIT NË GJYKATËN KUSHTETUESE

Në mbështetje të nenit 16, të ligjit nr.7491, datë 29.4.1991 "Për dispozitat kryesore kushtetuese" dhe në zbatim të neneve 18 dhe 28 të ligjit nr.7561, datë 29.4.1992 "Për disa ndryshime e plotësime në ligjin nr.7491, datë 29.4.1991 "Për dispozitat kryesore kushtetuese"", me propozimin e një grupi deputetësh,

KUVENDI POPULLOR
I REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

V E N D O S I:

Neni 1

Gjykata Kushtetuese e hedh vetë shortin jo më vonë se 30 ditë nga data kur mbaron afati 3 vjeçar për ripërtëritjen e anëtarëve të saj.

Neni 2

Në rast se shorti nuk hidhet brenda afatit të përcaktuar në nenin 1 nga vetë Gjykata Kushtetuese, atëherë ngarkohet Kryetari i Kuvendit Populllor të realizojë menjëherë hedhjen e këtij shorti.

Neni 3

Për hedhjen e shortit krijohet një komision ad hoc, i përbërë nga 5 anëtarë, i cili miratohet nga Kryetari i Kuvendit Populllor (ose nga Gjykata Kushtetuese sipas parashikimit të nenit 1). Në këtë komision marrin pjesë 1 anëtar i Komisionit të Përhershëm Parlamentar të Ligjeve, 1 anëtar i Komisionit të Përhershëm Parlamentar të Mandateve, Imunitetit dhe Rregullores, 1 përfaqësues nga Presidenca, Kryetari i Shoqatës së Gjyqtarëve ose 1 përfaqësues i caktuar prej tij dhe 1 përfaqësues nga Dhoma Kombëtare e Avokatëve. Në zhvillimin e këtij procesi ftohet të marrë pjesë edhe një sekretare e Gjykatës Kushtetuese. Anëtarët e komisioneve parlamentare propozohen nga kryetarët e komisioneve.

Komisioni ka për detyrë të zgjedhë edhe mënyrën e hedhjes së shortit, e cila duhet të jetë e tillë që të sigurojë fshehtësinë dhe objektivitetin e duhur për këtë proces.

Neni 4

Në hedhjen e shortit kanë të drejtë të të jenë të pranishëm anëtarët e Gjykatës Kushtetuese, të cilët njoftohen të paktën dy ditë përpara se të hidhet shorti.

Hedhja e shortit bëhet publike, në prani të publikut si dhe të gazetarëve me transmetim nga RTV Shtetëror.

Pas përfundimit të shortit Komisioni menjëherë shpall përfundimet e tij..

Neni 5

Ky ligj hyn në fuqi ditën e shpalljes nga Presidenti i Republikës.

Shpallur me dekretin nr.2016, datë 16.3.1998 të Presidentit të Republikës së Shqipërisë, Rexhep Meidani.